



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/219
Datë: 06.09.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 shtator 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në këtë përbërje:
 - Naim Bardiqi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, kryesues;
 - Fahrije Tërnavaj, Sekretare e Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, anëtare;
 - Ismajl Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, anëtar;
 - Driton Bajramaj, Menaxher i Personelit në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, anëtar;
 - Sytrime Dervisholli, Eksperte e Jashtme, anëtare.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë